



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:113482  
Datë: 01.03.2024  
Numri i dokumentit: 05397114

Pml.nr.76/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Rasim Rasimi, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit M. G., nga P., për shkak të veprës penale “Kanosja” nga neni 181, paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.1142/2023, të datës 14.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 26.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të dënuarit M. G., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1142/2023, i datës 14.12.2023 dhe kjo çështje penale i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.456/2023, të datës 11.07.2023, i dënuari M. G., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Kanosja” nga neni 181, paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së dhe ndaj të njëjtit është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim

do të ekzekutohet pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, ndërsa konform neni 79 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar, të dënuarit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 20.05.2023.

E dëmtuara A. Q., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Është detyruar i dënuari M. G., që të paguan taksën për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej njëzet (20) euro dhe paushallin gjyqësor në shumë prej tridhjetë (30) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1142/2023, e datës 14.12.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtëses së të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësja e të dënuarit M. G., avokatja Shqipe Ramushi, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke propozuar që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa të anulohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe çështja t'i kthehet kësaj gjykate në rigjykim.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.44/2024, e datës 07.02.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të dënuarit M. G., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi shqyrtojë shkresat e lëndës dhe pasi i vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoi se:

- kërkesa është e bazuar.

Mbrojtësja e të dënuarit M. G., në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se seanca e kolegjit pranë gjykatës së shkallës së dytë është mbajtur pa praninë e të dënuarit, edhe pse ndaj të njëjtit ishte vazhduar paraburgimi derisa sa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë. Në këtë mënyrë, sipas mbrojtëses së të dënuarit, mos prania e të dënuarit në seancën e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që bazuar në nenin 390, paragrafi 2 të KPP, gjykata e shkallës së dytë është dashur që ta sigurojë praninë e të dënuarit në seancë, duke e pasur parasysh se i njëjti ka qenë nën masën e paraburgimit, sipas aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikojë shkresat e lëndës dhe analizojë pretendimin e mbrojtëses së të dënuarit M.G., konstatoi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është

përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 390, paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së.

Kjo për faktin se nga shkresat e lëndës, shihet se seanca e kolegjit në gjykatën e shkallës së dytë është mbajtur më datën 14.12.2023, ndërsa në këtë seancë nuk ka marrë pjesë i dënuari M. G., edhe pse nga shkresa e lëndës shihet se ndaj tij me aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë është vazhduar paraburgimi derisa sa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Në këtë rast, nga shkresat e lëndës nuk rezulton që gjykata e shkallës së dytë të ketë bërë përpjekje për ta siguruar prezencën e të dënuarit M. G., në seancë të kolegjit, edhe pse gjykata në fjalë lehtësisht ka mundur ta vëren se i dënuari gjenden nën masën e paraburgimit.

Në këtë mënyrë, rezulton që i dënuari M.G., nuk është njoftuar në mënyrë të rregullt për seancën e kolegjit që është mbajtur në gjykatën e shkallës së dytë më datën 14.12.2023, ndërsa duke e marrë për bazë faktin se ndaj të dënuarit është shqiptuar dënim me burgim, atëherë bazuar në nenin 390, paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, është dashur që i njëjti të njoftohet në mënyrë të rregullt për seancën e kolegjit, duke e pasur parasysh se ndaj të dënuarit ishte vazhduar paraburgimi me aktvendim të gjykatës së shkallës së parë.

Përndryshe, mos njoftimi i palëve për seancën e kolegjit, përveç që përbën shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale të theksuar më lart, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, paraqet edhe shkelje të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Për raste të tilla, me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Kl.nr.104/2016 të datës 29.05.2017, është konstatuar se (bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut), garancitë e përmbajtura në nenin 6, paragrafët 1 dhe 3. të Konventës, vazhdojnë të zbatohen në të gjitha fazat e procedurës penale. E drejta për mbrojtje, sipas dispozitës së lartcekur të Konventës, përfshin të drejtën e të akuzuarit për të mbrojtur veten, të drejtën për ndihmë juridike, duke përfshirë ndihmën juridike falas, si dhe të drejtën e të akuzuarit që të jetë i pranishëm në të gjitha veprimet në procedurë. Duke mos ia mundur të akuzuarit që të merr pjesë në seancën e gjykatës së shkallës së dytë lidhur me akuzën penale kundër tij, sipas konkludimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në anën tjetër, edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në disa raste nga jurisprudenca e saj e ka trajtuar në hollësi çështjen e njoftimit të të akuzuarit për pjesëmarrje në seancë pranë gjykatës së apelit, duke e konsideruar këtë aspekt si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt, nga neni 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (çështja *“Tierce dhe të tjerët kundër San Marinos”*,

aktgjykimi i datës 25.07.2000; çështja “*Hermi kundër Italisë*”, aktgjykimi i datës 18.10.2006; çështja “*Ekbatani kundër Suedisë*”, aktgjykimi i datës 26.05.1988, etj.).

Në këtë mënyrë, bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart, rezulton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, andaj edhe si rezultat i kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovoi si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtëses së të dënuarit M. G., ndërsa e anuloi këtë aktgjykim, duke e kthyer çështjen në rigjykim.

Shkelja esenciale të dispozitave të procedurës penale me të cilën është përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është e asaj natyre që nuk ka mundur që të evitohet nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që e njëjta ka qenë arsye që ka imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në këtë gjykatë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së dytë duhet që ta evitoj shkeljen e cekur më lartë, duke i njoftuar me rregull palët dhe avokaten mbrojtëse për datën dhe orën e mbajtjes së seancës së kolegjit dhe më pastaj, të shqyrtoj pretendimet në kuadër të ankesës së paraqitur dhe të merr një vendim merititor.

Nga arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË  
Pml.nr.76/2024, më datë 26.02.2024

Procesmbajtës,  
Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit,  
Agim Maliqi